



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

PROJEKT-VENDIM

Nr. 8, datë 21.09.2026

PËR

**“DISA NDRYSHIME NË VKB NR 14 DATE 24.02.2026 “PËR NDRYSHIMIN E VKB NR 74
DATE 23.12.2025 PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2026 – 2028, NUMRIN E PUNONJËSVE
TË BASHKISË VAU DEJËS ”**

Mbështetur në nenin 9, neni 34, 37, 40, 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; neni 4, kreu III, nenet 10, kreu IV, nenet 22-24, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” , Ligjin 87/2025 “Per buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës, Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I:

- Të miratojë ndryshimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2026 - 2028, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë :
- 1. Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 01 (transferte e pakushtëzuar e përgjithshme), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2026-2028 , të ndara në kapitale, sipas tabelës 1 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
- 2. Fondet buxhetore do kalojnë në **programin buxhetor 04520 “Rrjeti Rrugor Rural”** për financimin e **projektit “ Sistemim, asfaltim rrugët e brendshme Kosmaç”** në vlerën **10,991,477**

- lekë, Llog.Ekonomike 231- Shpenzime kapitale të trupëzuara**, instistucioni Bashkia Vau Dejës, sipas tabelës Nr.1 së bashkëlidhur këtij projekt vendimi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe

Aseteve

Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike

Institucioni: Bashkia Vau Dejës
Tabela Nr 1: "Rishpërdarje e buxhetit ndërmjet programeve të Kap 01".

PAKËSOHET

Në Lekë										
Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04240	2300000	3333	1570888	10,991,477.00	Studim projektim rrjeti i dyte ujites Njesia Administrative Bushat
SHUMA TOTALE Kap 01										
									10,991,477.00	

SHTOHET

Në Lekë										
Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	04520	2310000	3333	1570830	10,991,477.00	Sistemitim ,asfaltim rrugët e brendshme Kosmac
SHUMA TOTALE Kap 01										
									10,991,477.00	

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues

Kryetar

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU I DEJES
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCES
RELACION FINANCIAR**

PËR

“DISA NDRYSHIME NË VKB NR 14 DATË 24.02.2026 , PËR NDRYSHIMIN E VKB NR 74 DATË 23.12.2025 PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 TË BASHKISË VAU DEJËS”

I. QELLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QE SYNOHEN TE ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 14 datë 24.02.2026 “Për ndryshimin e VKB Nr 74 datë 23.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028, të Bashkisë Vau Dejës, të konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresë nr 165/1 prot datë 03.03.2026.

Tek tabela nr.1 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi paraqitet rishpërndarja e buxhetit ndërmjet programve me kapitull 01 për paksimin e zërit të investimit me emertim “*Studim projektim rrjeti i dyte ujites Njesia Adminsitrative Bushat*”, me kod projekti 1570888 dhe kod programi 04260 dhe në shtesë buxheti për investimin me emertim “**Sistemim, asfaltim rrugët e brendshme Kosmac**” me kod projekti 1570830 dhe kod programi 04520 **Rrjeti Rrugor Rural**, projekt ky që është pjese e listes së prioriteteve për Vitin 2026 të miratuara me VKB nr.76 datë 23.12.2025 me Shprehje Ligjshmërie Nr.884/1 prot. Datë 07.01.2026.

Zbritja e fondeve buxhetore nga zëri i investimit “Studim projektim rrjeti i dyte ujites Njesia Adminsitrative Bushat”, me kod projekti 1570888, vjen si rezultat i vlersimeve te perditesuara te brendshme te institucionit, mbi mundesite e realizimit te ketij investimi, i cili nuk konsiderohet me i mundshem kete vit.

Sa më sipër ,kërkohet miratimi i këtyre ndryshimeve të VKB-së nr.14 datë 23.12.2025 “Për ndryshimin e VKB Nr 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Vau Dejës” .

II. VLERESIMI I PROJEKT VENDIMIT NE RAPORT ME PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028, DHE ME BUXHETIN E VITIT 2026.

Projekt Vendimi eshte parashikuar duke u bazuar ne politikat dhe strategjine e programit te PBA-se 2026-2028 dhe me Buxhetin e vitit 2026

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT LIDHUR ME PERPARESITE, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues per projektvendimin mbi “Disa ndryshime ne VKB nr 14 datë 24.02.2026 Për ndryshimin e VKB Nr 74 datë 23.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”

Perparesia e ketij projektvendimi eshte permiresimi i sherbimit te ofruar nepermjet planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe i mire-analizuar i shpenzimeve publike me synim rritjen e efektivitetit dhe perdorimit ekonomik te fondeve publike;

- Menaxhimi efektiv i te ardhurave totale te bashkise si nje menyre e rendesishme per te rritur investimet dhe ne interesin publik;
- Rritje e cilesise se infrastruktures ne territorin e bashkise
- Konsolidimi i sherbimeve publike:
- Nxitje e zhvillimit ekonomik per bizneset:
- Ndërtimi i infrastrukturës moderne:Infrastruktura rrugore,arsimore parauniversitare.

IV. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDERKOMBETAR

Ky projektvendim eshte ne harmoni te plote me ligjin nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar,

Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore,

Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar,

Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 30.07.2018

"Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV";

Udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit",

Ligji 87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026" ,

Udhezimit Plotesues nr 02 date 14.01.2026 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2026",

KRYETAR
Kristian SHKRELI

